



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNCIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI



Gjilan, Rr. "Bulevardi i pavarësisë" tel: 0280 320 - 587 0280 320 - 111

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

REFERENC-Ë:					
PËR/ZA/TO:			Kryetarin e Komunës – z. Lutfi Haziri		
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:			Ensar Kadriu - Drejtor i D.M.SH		
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:			Raport i punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për periudhën janar-mars 2016		
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		Data:	26.05.2016

I nderuari z. Kryetar

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë kësaj periudhe raportuese, zhvillon aktivitete në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat i referohen fushë veprimtarisë të kësaj drejtorie. Aktivitetet e drejtorisë janë kohezive dhe vazhdojnë sipas intensitetit që përcaktohet nga kushtet e përgjithshme shoqërore dhe klimatike.

Gjatë këtyre muajve janë zhvilluar aktivitete të shumta, të cilat përfshijn një gamë të gjerë të aktiviteteve brenda drejtorisë dhe të cilat në radhë të parë synojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale në drejtorinë tonë duke përfshirë dhe aftësimin e zyrtarëve të DMSH–ës, SHZSH si dhe Inspektoratit të Preventivës duke u bazuar në planin e aftësimit profesional të përpiluar nga AME (Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave), si dhe aftësimin e vullnetarëve të rinj në qendrën e aftësimit profesional në Vushtrri, me qëllim të mobilizimit dhe angazhimit në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Aktivitetet e zhvilluara të DMSH–ës janë të koordinuara me subjektet të tjera publike të cilat zhvillojnë aktivitet në komunën tonë duke përfshirë drejtoritë komunale, Policinë e Kosovës, FSK-në Hidromoravën, etj.

Në vazhdim po paraqesim disa nga aktivitetet tona të cilat përbëjnë thelbin e veprimtarive gjatë kësaj periudhe raportuese:

Bashkëpunimi me Drejtorinë për Shërbime Publike karakterizohet në aksione të përbashkëta në përballjen me fatkeqësitë që goditën komunën tonë nga reshjet e shiut, nga data 07 deri me

12.03.2016, ku janë koordinuar aktiviteti për parandalimin, sanimin dhe kthimin e funksionalitetit në hapësirat e goditura. Me këtë drejtori është koordinuar aktiviteti në intervenime të përbashkëta në ndihmë qytetarëve për eliminimin e rrezikut nga pasojat e vërshimeve dhe në aktivitete tjera të cilat kanë qenë në interes të qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Gjatë kësaj periudhe me aktivitet të përbashkët janë identifikuar vendet ku duhet intervenuar për eliminimin e pengesave të cilat kanë shkaktuar vërshimet;

- Me këtë problematikë bashkëpunimi dhe aktiviteti i përbashkët është zhvilluar edhe me ndërmarrjen publike “Hidromorava”, e cila ndërmarrje është angazhuar në dërgimin e ujit të pijshëm në fshatin Nasalë ku si pasojë e daljes nga shtrati të lumit Morava janë ndotur pusët e ujit të pijshëm.
- Me Drejtorinë e Arsimit kemi filluar aktivitetin për njoftimin dhe aftësim të nxënësve dhe arsimtarëve me përballjen e pasojave nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera elementare. Për këtë qëllim në bashkëpunim me organizatën “Save the Children”, ne si drejtori do të implementojmë dhe do të merremi me organizimin e trajnimit praktik një ditore në shkollën “Abaz Ajeti” dhe në Institucionin parashkollor “Integji”.
- Angazhimi në identifikimin e familjeve në nevojë për banim social;
- Gjithashtu ne si drejtori, në vazhdimësi vlerësojmë mundësitë e rreziqeve nga faktorët e tjerë, nga ku popullata e komunës tonë dhe prona mund të rrezikohen në mënyrë masive;
- Kemi bërë vlerësimin për gjendjen e sigurisë fizike të objekteve të komunës dhe propozimin për kapacitetet e nevojshme të ruajtjes;
- Nga drejtoria jonë është hartuar Plani i Reagimit Emergjent, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Komunës

Aktiviteti dhe disiplina në këtë drejtori është në rritje dhe përgjegjësia e kryerjes së detyrave është gjithnjë më e mirë.

Si pjesë e këtij raporti janë edhe raporti i SHZSH-së dhe sektorit të preventivës ku pasqyrohen aktivitetet konkrete në dhënie të shërbimeve me qëllim të ruajtjes së jetës dhe pronës së qytetarëve sidomos gjatë vërshimeve që goditën komunën tonë.

Raportit i bashkëngjishim edhe punën e inspektorëve të preventivës dhe intervenimeve të SHZSH-së

- Pasqyrimi tabelor i aktiviteteve të inspektorëve të preventivës**

Në këtë periudhë raportuese janë kryer kryesisht inspektime të rregullta dhe vend-shqime në vendin e ngjarjes gjatë dhe pas zjarreve të shkaktuara me këtë rast janë hartuar raportet mbi zjarrin dhe sipas kërkesave të palëve atyre iu janë lëshuar edhe vërtetime mbi zjarrin.

Inspektimet e		Sektori i Pasurisë			Numri i objekteve të inspektuara sipas kategorisë					Nr. i masave të propozuara	Nr. i aktvendimeve të marura	Nr. i masave të urdhëruara	Nr. i pëlqimeve në dok. Investivo-teknik	Nr. i vendshiqimeve të zjarrit	Nr. i rapoteve mbi zjarrin	Nr. i vërtetimeve mbi zjarrin
Rregullta	Gjithsejt	Shoqërore	Privat	Gjithsejt	I	II	III	IV	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt	Gjithsejt
38	38	20	18	38	2	18	18	-	38	151	10	36	17	6	6	5

- Pasqyrimi tabelor i aktiviteteve të SHZSH-së**

	Lloji Intervenimeve	Janar	shkurt	Mars	Gjithsej
1	Zjarre	24	11	17	52
2	Intervenime teknike	1	1	3	5
3	Shërbimet	1	1	2	4
4	Lajm. I rrejshëm	1	1	2	4
5	Vërshime	7	0	15	22
6	Eksplodime /Gatishmëri	/	/	/	0
7	Ushtrime	/	/	/	0
	Gjithsej	34	14	39	87

Në krahasim me hapësirën që mbulojmë dhe me numrin e banorëve të komunës tonë, kemi numër të vogël të zjarrfiksive, mirëpo përkundër këtyre vështirësive, kemi arritur që t'i përmbushim nevojat e qytetarëve në parandalimin e përhapjes së zjarreve dhe dëmtimit në masë të pasurisë dhe pronës private dhe publike.